



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
FAKULTETI I SHKENCAVE MATEMATIKE NATYRORE

Rr. Eqrem Çabej, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381-38-249-873 • E-mail: fshmn@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

FSHMN

Ref. nr. 1388

Prishtinë, Dt. 06/05/2025

RAPORT VLERËSIMI TË DORËSHKRIMIT TË PUNIMIT TE DIPLOMES
MASTER

FAKULTETI	FSHMN
Departamenti/ Programi	Matematikë / Master në Shkencë Kompjuterike
Projekt propozimi	Ndikimi i inteligjencës artificiale në analizën e tregjeve financiare dhe marrëdhëniet e tyre me performancën e investimeve
Kandidati	Vedat Imeri
Mentori	Prof. Ass. Dr. Ujkan Bajra
Aprovimi i projekt propozimit në Këshillin e Fakultetit	Datë: 04.10.2024 Vendimi nr.: 4097

Vlerësimi i dorëshkrimit

Hyrje

Punimi i diplomës me titull "Ndikimi i inteligjencës artificiale në analizën e tregjeve financiare dhe marrëdhëniet e tyre me performancën e investimeve" përqendrohet në ndikimin e AI në analizën e tregut financiar, me një fokus të veçantë në tregun valutor (FOREX) dhe marrëdhënien e tij me performancën e investimeve. Duke shfrytëzuar algoritme të avancuara të mësimit të makinës, rrjeteve nervore dhe modele hibride, AI ka përmirësuar saktësinë, shpejtësinë dhe efikasitetin e analizës financiare, duke ofruar avantazhe të dukshme krahasuar me metodologjitë tradicionale. Studimi adreson pyetje kërkimore kyçe si: mënyrat e përdorimit të AI në analizën financiare, avantazhet dhe sfidat e tij, ndikimi në performancën e investimeve dhe minimizimin e rreziqeve, si dhe perspektivat për përmirësimin e mëtejshëm të kësaj teknologjie.

Kriteret e vlerësimit

Vlerësimi i dorëshkrimit është bërë në sajë të punës origjinale, cilësisë hulumtuese, metodologjisë, analizës dhe prezantimit në dorëshkrim.

Përmbajtja e detajuar

Në Kapitullin 1, kandidati argumenton se AI ka revolucionarizuar mënyrën e analizës dhe vendimmarrjes në financa duke ofruar parashikime më të sakta, përpunim të të dhënave në kohë reale dhe rritje të efikasitetit. Autori thekson avantazhet e AI ndaj metodave tradicionale, por gjithashtu trajton edhe rreziqet dhe sfidat që lidhen me transparencën, paragjykimet algoritmike dhe rreziqet sistemike. Qëllimi i përgjithshëm i kapitullit është të vlerësojë rolin e AI në përmirësimin e performancës së investimeve financiare dhe të ngrejë pyetje për zhvillime të mëtejshme në këtë fushë.

Në Kapitullin 2 është bërë rishikimi i literaturës dhe përshkrimi i zbatimit të inteligjencës artificiale. Ky kapitull shqyrton përdorimin e Inteligjencës Artificiale (IA) në analizën e tregjeve financiare, duke u fokusuar në tregun FOREX. Kapitulli gjithashtu thekson sfidat si cilësia e të dhënave, luhatshmëria e tregut dhe shqetësimet rregullatore në përdorimin e IA-së në tregtimin FOREX.

Në Kapitullin 3 analizohet tregu valutor (FOREX) me fokus në 5 valutat kryesore botërore (USD, EURO, CHF, GBP dhe JPY). Përdoren analiza fundamentale, analiza teknike dhe analiza e sentimentit të tregut. Paraqiten dhe Modele të ndryshme të cilat përdorin Support Vector Machine, Long Short-Ter Memory dhe Yfinance.

Në Kapitullin 4 kandidati shpjegon konfigurimin e modelit SVM, pastaj bën interpretimin e rezultateve dhe në fund analizën krahasuese me autorët e tjerë.

Në Kapitullin 5 kandidati paraqet konkluzionet dhe puna në të ardhmen e cila duhet të fokusohet në përmirësimin e metodave të analizës dhe optimizimin e modeleve të IA.

Përmbledhje e të gjeturave


Punimi i diplomës Master me titull “Ndikimi i inteligjencës artificiale në analizën e tregjeve financiare dhe marrëdhëniet e tyre me performancën e investimeve” ka një analizë të mirë, shqyrtim të literaturës dhe analizë të të gjeturave. Kandidatit iu është kërkuar nga anëtarët e komisionit të përmirësojë detaje të caktuara në secilin kapitull, të cilat ai i ka inkorporuar në punim diplomës.

Konkludim


Në përgjithësi tema e diplomës me titull "Ndikimi i inteligjencës artificiale në analizën e tregjeve financiare dhe marrëdhëniet e tyre me performancën e investimeve" i studentit Vedat Imeri i përmbush standardet për të fituar gradën shkencore Master. Komisioni rekomandon pranimin e temës, pas ndryshimeve të vogla, të cilat kandidati i ka rregulluar, duke i përcjellë komentet e anëtarëve.

Prishtinë, 06.05.2025


Komisioni:

1. 

Prof. Assoc. Dr. Emir Rogova – kryetar

2. 

Prof. Ass. Dr. Ujkan Bajra – anëtar

3. 

Prof. Ass. Dr. Eliot Bytyçi – anëtar